

**Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare - Konferencë Kombëtare**  
**“SFIDAT E ZHVILLIMIT TË TREGJEVE NËN MBIKËQYRJEN**  
**E AMF-SË DHE EDUKIMI FINANCIAR”**

**24 Maj 2018 - Tiranë, Shqipëri**

**NDIKIMI I POLITIKËS FISKALE NË ORGANIZIMIN E TREGUT TË**  
**INSTRUMENTEVE TË BORXHIT PUBLIK**

**Lorena BALLA<sup>1</sup>**

**Fiona BALLA<sup>2</sup>**

***Abstrakt***

Politika fiskale mund të jetë një nga faktorët më të rëndësishëm dhe vendimtar në përcaktimin e normës së kthimit të obligacioneve qeveritare. Ashtu siç dihet, politika fiskale e ndërmarrë nga qeveria mund të nxisë ose tkurrë zhvillimin ekonomik të vendit.

Ky punim ka për qëllim të vlerësojë çështjet që lidhen me politikën fiskale të zbatuar në vend, borxhin publik dhe ndikimin në përcaktimin e normës së kthimit nga obligacionet qeveritare duke shqyrtuar si rolin e tregut në këtë përcaktim, por edhe rolin e qeverisë me instrumentet e saj fiskalë për menaxhimin e borxhit publik.

Këndvështrimi do të shtrihet edhe mbi sistemin tatimor i cili përcakton një pjesë të mirë të rishpërndarjes së të ardhurave në vend, duke reduktuar ose rritur mirëqenien ekonomike. Shumë thelbësor është gjithashtu roli dhe aftësia që kanë hartuesit e politikës fiskale në rritjen e të ardhurave nga taksat dhe financimin e të mirave e shërbimeve publike me këto të ardhura dhe me fondet e marra nga borxhi publik i brendshëm, duke minimizuar kostot që mund të prekin rritjen ekonomike. Si rrjedhim pritet që një politikë fiskale më e besueshme do të ulë risqet e investitorëve, do të ndikojë në mirëorganizimin e tregut të instrumenteve të borxhit publik dhe të nxisë rritjen ekonomike.

Metodologjia e përdorur në këtë punim është rishikimi i literaturës ekzistuese që mbulon këtë fushë dhe krahasimi me disa nga vendet e rajonit, duke rekomanduar kërkime të mëtejshme që mbështesin dhe nxisin një politikë fiskale në favor të rritjes ekonomike.

***Fjalë kyçe:*** *Politikë fiskale, Instrumente Borxhi, Normë kthimi, Rishpërndarje të ardhurash, Borxh Publik.*

---

<sup>1</sup> Deloitte Albania, [lorenaballa1@gmail.com](mailto:lorenaballa1@gmail.com)

<sup>2</sup> Deloitte Albania, [ballafiona@yahoo.com](mailto:ballafiona@yahoo.com)